



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 dhe 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 ,nenit 12 të Rregullores për varrezat ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 15Nr.400-71876 e datës 27.11.2018, Rregullores 15Nr. 011-15426 e datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 15Nr.400-71876 e datës 27.11.2018 si dhe nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 13 të Rregullores për ndarjen së subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 17.03.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

## V E N D I M

### PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT TË QYTETARËVE ME VENDBANIM TË PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

- I. Me këtë Vendim **përcaktohet** që shuma për subvencionimin e shërbimeve të Varrimit për qytetarët e Komunës së Lipjanit të jetë **210 €** për një varrim.
- II. Autorizohet , Kryetari i Komunës që të lidh Marrëveshje me shkrim me institucionet fetare që veprojnë në territorin e Komunës së Lipjanit për kryerjen e shërbimeve të varrimit konform dispozitave të këtij Vendimi dhe legjislacionit në fuqi .
- III. Subvencionimi i shpenzimeve për shërbimet e varrimit do të bëhet për çdo person të vdekur për të cilin në bazë të ekzaminimeve mjekësore në pajtim me dispozitat ligjore është konstatuar vdekja . Në shërbimet e varrimit përfshihen : Lajmrimi për varrimin, hapja e varrit, dërrasat, piramida, kryerja e riteve fetare, pastrimi i kufomës, mbulesa e kufomës dhe qefini.
- IV. Kryetari i Komunës pas pranimit të raportit mbi vdekjet me dokumentacionin e bashkëngjitur nga ana e institucionit fetar nxjerr Vendim për ekzekutimin e pagesës në baza mujore.

V.Mjetet financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit do të paguhen nga buxheti i Komunës përkatësisht nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe do të derdhen në xhirollogaritë e Institucioneve Fetare përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të varrimit.

VI. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa

VII. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës .

VIII. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit 15Nr.400-71876 i datës 27.11.2018.

15Nr. 400-15449

Lipjan, më 17. 03. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

